

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për çështje administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Hasan Shala dhe Ramiz Kuqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, IPKO Telecommunications LLC, me seli në Prishtinë, rr. "Z. Shemsiu"nr.34, kundër të paditurës, Komuna Hani i Elezit, me bazë juridike anulim i aktit administrativ të organit të paditur, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të ushtruar nga i autorizuari B.H., zyrtar për çështje juridike, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative A.nr.1604/2012, të datës 23.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2016,bien;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses, IPKO Telecommunications, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, A.nr.1604/2012, i datës, 23.12.2015, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, me aktgjykimin e ankimuar, e ka refuzuar si jo të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me të cilën ka kërkuar anulimin e Vendimit të paditurës,nr.02/nr.7835/2012,të datës 12.12.2012.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditëses, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i njëjti të prishet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit shqyrtoi pretendimet ankimore, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës, , dhe pas vlerësimit të tyre si në kuptim të nenit 49, par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA),dhe neni 194 i Ligjit për procedurën kontestimore,(Ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me Vendimin e komisionit për ankesa të Komunës Hani të Elezit, nr. 02/nr.7835/12,të dt.12.12.2012, është refuzuar ankesa e IPKO, kundër Vendimit nr.10/7230/12,për pagesën e taksës sipas faturës nr.000187,paditësi është obliguar të paguaj shumën vjetore prej 1.000€, Komunës Hani i Elezit, për vendosjen e dy antenave të telefonisë mobile në territorin e kësaj komune, në zona rurale, në vështirësi të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe taksa administrative,nr.01/817, të dt. 30.04.2012, dhe në bazë të pëlqimit komunal të dhënë nga komuna.

E pa kënaqur me Vendimin e Bordit paditësja IPKO, ka ushtruar padi për inicimin e konfliktit administrativ kundër të paditurës dhe ka kërkuar që aktvendimi i kontestuar të anulohet në tërësi si jo i bazuar. Gjykata themelore në Prishtinë, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 23.12.2015,në praninë e përfaqësuesve të palëve, në bazë të provave dhe dëshmimeve të administruara si në procesverbal të shqyrtimit kryesor ,bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditëses si jo të bazuar për anulimin e vendimit të organit të paditur.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktin administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka shqyrtuar në mënyrë të tërësishme aktin administrativ të paditurës në suaza të thënijeje në padi, në seancat e mbajtura me përfaqësuesit e palëve ndërgjyqjese, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, dhe ka gjetur se vendimi Komisionit për ankesa, i K. Hani i Elezit, është i ligjshëm i bazuar në fakte të dëshmuara në bazë të dispozitave ligjore dhe Rregullores komunale të theksuar si në aktgjykimin e ankimuar të cilin gjithashtu edhe kolegji e miraton si vendim të drejtë dhe ligjor, i nxjerrë duke u mbështetur në dispozitat e Rregullores për pagesën e taksave, tarifave dhe ngarkesave administrative të K. Hani i Elezit, e cila rregullore është aprovuar edhe nga Ministria e Administrimit të pushtetit lokal, si ligjore në harmoni me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Ligjin për financa të pushtetit lokal, që sipas nenit 8 komunat kanë kompetencë që të nxjerrin rregullore për të hyrat vetanake me të cilat subjektet e ndryshme afariste ngarkohen me pagesa të taksave për zhvillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve të tyre të ofruara si në rastin konkret të paditësit, i cili i ka të vendosura dy antena për zhvillimin e veprimtarisë së saj me ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, në territorin e kësaj komune si në pëlqimin e dhënë nga organi kompetent komunal.

Pretendimet ankimore të paditëses të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë jo të bazuara dhe jo të qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështjeje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshkohet se aktgjykimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të LKA dhe LPK, siç pretendon paditësi. Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë e ka proceduar çështjen në baza ligjore e gjithashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe janë nxjerrë prova të mjaftueshme në bazë të cilave është vërtetuar se kërkesë padia është jo e bazuar, sepse janë në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar nga organi i paditur K. Hani i Elezit si në Vendimin e saj, i nxjerrë në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënë ligjore të cekura. Paditësja në ankesën e saj bënë interpretimin e dispozitave ligjore si nenit 8, 10 dhe 11, të Ligjit për financa në të cilën e bazon të drejtën e tij, duke pretenduar se nuk ushtron veprimtari dhe nuk ka lokale (njësi biznesore) në territorin e Komunës së Hanit të Elezit për tu nxjerrë vendim meritore në bazë të dispozitave ligjore të cekura si më lartë etj, kolegji gjithashtu i vlerëson si jo të qëndrueshme këto pretendime, sepse vendosja e antenave telefonike në paluajtshërit e cekura, në K. Hani i Elezit është bërë me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë profitabile, e që veprimtaria e tillë ushtrohet për mes locimit të antenave dhe transmetuesëve për ofrimin e shërbimeve telefonike dhe të tjera, andaj komuna duke u bazuar në rregulloren e saj komunale të cekur si më lartë e ka ngarkuar me pagesën e taksës si në vendimin e saj.

Mbi këtë gjendje të fakteve të provuara, kolegji konstaton se çështja në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të organit administrativ përfundimtar është shqyrtuar në mënyrë të argumentuar në baza ligjore, andaj pretendimet ankimore kolegji i vlerëson jo me ndikim për tu vërtetuar gjendje tjetër faktike, dhe për të vendosur ndryshe nga ajo e vendosur në gjykatën e shkallës së parë. Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
A.A.nr.41/2016, datë 21.03.2016

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani